





Roli i Koordinatorit të Digjitalizimit në shkollat profesionale



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:


swisscontact

Ky publikim është prodhuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J) nën mbikqyrjen e Prof. Asoc. Dr. Erka Çaro, Zv. Menaxhere Projekti dhe Eriola Shingjergji, Menaxhere e Linjës për Digitalizimin në AFP.

Autore

Irena Majko
Megi Duçi

Kontributorë

Dorian Memoçi
Ermira Mani
Gentjana Hazinedari
Gjenovefa Xhakaj
Juljan Kasapi
Meralda Mahilaj

Rreth projektit “Aftësi për Punë” (S4J)

Aftësi për Punë (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga Swisscontact, i cili synon të adresojë sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri. Që prej tetorit 2015, projekti “Aftësi për Punë” (S4J) mbështet qeverinë dhe aktorët e tjerë të interesit për të ndërtuar një sistem cilësor të AFP në Shqipëri, i frymëzuar nga modeli zviceran. Në fazën e tij të tretë (2024-2027), me theks të veçantë tek qëndrueshmëria, projekti është angazhuar në ndarjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe përvojave të përftuara në nivel sistemi, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat partnere.

Pronësia intelektuale

© Ky publikim është pronësi ekskluzive intelektuale e projektit “Aftësi për Punë” (S4J). Publikimi mund të aksesohet, lexohet, shkarkohet apo printohet vetëm për përdorim personal. Ndalohet riprodhimi, shpërndarja, shitja, shfaqja, ndryshimi apo përshtatja e çdo materiali që përfshihet në publikim pa autorizim nga S4J.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht pozicionin zyrtar të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Përmbajtja

Hyrje	1
Metodologjia	2
Roli i Personit Kyc të Digjitalizimit në transformimin digjital në arsimin profesional.....	2
Qëllimi i rolit të Personit Kyç të Digjitalizimit.....	2
Konteksti i zhvillimit të rolit të Personit Kyc të Digjitalizimit.....	3
Profili i Personit Kyç Të Digjitalizimit.....	3
Aftësitë Teknike	4
Aftësi koordinuese	5
Aftësi pedagogjike.....	6
Aftësi komunikimi.....	6
Aftësi vlerësimi.....	7
Detyrat dhe përgjegjësitë.....	7
Zhvillimi profesional i personit kyç të digjitalizimit si agjent ndryshimi në shkollë	10
Trajnimi për përdorimin dhe menaxhimin e platformës Mesovet	11
Trajnim për t'u certifikuar si Edukator nga Moodle (Moodle Educator Training).....	11
Trajnimi për zhvillimin dhe përdorimin e materialeve digjitale.....	12
Programi Pedagogjia Digjitale	12

Hyrje

Arsimi dhe formimi profesional është duke u transformuar dhe integrimi i teknologjisë dhe platformave digjitale është bërë një domosdoshmëri për përmirësimin jo vetëm të procesit mësimdhënës, por edhe të menaxhimit institucional. Një nga inovacionet kryesore në shkollat profesionale ka qenë përdorimi i MësoVET, një platformë mësimore e adaptuar në shqip nga S4J posaçërisht për AFP-në, bazuar në Moodle. Përdorimi i kësaj platforme fillimisht nisi nga një numër i vogël mësuesish që menjëherë kuptuan rëndësinë dhe përfitimet e përdorimit të teknologjisë në edukim. Për të mbështetur të gjithë mësuesit dhe nxënësit, dhe për ta bërë këtë praktikë të qëndrueshme, projekti ‘Aftësi për Punë’ ndërmoi hapa për përditësimin e platformës, zgjerimin e funksionaliteteve dhe shtimin e materialeve mësimore digjitale që nxisin ndërveprimin dhe fleksibilitetin në procesin mësimor.

Ky transformim jo vetëm që përmirëson cilësinë e procesit mësimor, por gjithashtu ndryshon mënyrën se si menaxhohen dhe monitorohen rezultatet dhe performanca e nxënësve. Shkollat po investojnë në përdorimin e platformave digjitale pasi kanë kuptuar se teknologjia është bërë një komponent kyç për përgatitjen e nxënësve për tregun e sotëm të punës, ku aftësitë digjitale janë të domosdoshme. Përmes përdorimit të platformave digjitale dhe mjeteve teknologjike, nxënësit jo vetëm që zhvillojnë aftësi teknike të rëndësishme, por gjithashtu mësojnë të përshtaten në një mjedis pune gjithnjë e më të digjitalizuar. Në këtë mënyrë, digjitalizimi në arsim jo vetëm që nxit inovacionin, por edhe krijon ura më të forta midis arsimit dhe nevojave të tregut të punës.

Duke marrë parasysh zgjerimin e përdorimit të platformave dhe mjeteve digjitale, si dhe nevojën për krijimin e autonomisë në përdorimin e teknologjisë nga mësuesit në shkolla, në vitin 2022 projekti ‘Aftësi për Punë’ krijoi rolin e *koordinatorit të digjitalizimit*, që në fillimet e tij u quajti **Personi Kyç i Digjitalizimit**. Për këtë arsye, gjatë gjithë dokumentit do t’i referohemi me *këtë emërtesë*.

Ky rol mori një rëndësi të veçantë në lehtësimin e procesit të integritit të teknologjisë në arsim. Që nga krijimi i tij, Personi Kyç i Digjitalizimit ka marrë përgjegjësinë për të mbështetur mësuesit dhe nxënësit në përdorimin efektiv të platformave digjitale. Puna e tyre synon të sigurojë që platforma si MesoVET të funksionojnë pa ndërprerje dhe të përmbushin nevoja specifike të shkollës.

Pas dy vitesh, ky rol ka arritur në një pikë ku kërkohet përmirësim dhe ridimensionim, duke e kthyer në një pjesë integrale të strukturës institucionale. Roli i tyre duhet të ketë përgjegjësi të qarta dhe të funksionojë në mënyrë të pavarur, për të avancuar më tej procesin e digjitalizimit në shkollë. Për këtë arsye, ky dokument synon të analizojë dhe të përmirësojë rolin e Personit Kyç të Digjitalizimit duke ofruar një pasqyrë të detajuar mbi përgjegjësitë e tyre kryesore, sfidat me të cilat përballen dhe mundësitë për optimizimin e këtij roli në të ardhmen.

Metodologjia

Për hartimin e këtij dokumenti janë realizuar intervista dhe fokus grupe, të cilat synuan përfshirjen e të gjithë aktorëve brenda shkollës për të kuptuar nga afër impaktin e Personit Kyç të Digjitalizimit dhe rolin e tij/saj në zbatimin e proceseve të lidhura me digjitalizimin. Procesi i mbledhjes së feedback-ut filloi me një fokus grup, ku morën pjesë 6 Persona Kyç të Digjitalizimit nga shkollat partnere të projektit "Aftësi për Punë". Ky fokus grup shërbeu për të kuptuar më mirë përvojën dhe këndvështrimin e tyre mbi përgjegjësitë dhe sfidat e pozicionit.

Së dyti, u zhvillua një intervistë me përfaqësues të Wide Services, një partner i certifikuar i Moodle, të cilët kanë ndjekur nga afër trajnimet dhe zhvillimin profesional të Personave Kyç të Digjitalizimit në këtë drejtim. Me ta u diskutuan aspekte teknike të platformës dhe programe kapacituese që ju vijnë në ndihmë për të përmbushur rolin.

Së treti, u zhvillua një fokus grup me nxënës përfaqësues nga 4 shkolla partnere, ku morën pjesë 12 nxënës për të marrë feedback lidhur me nevojat e tyre dhe sesi këto nevoja adresohen dhe zgjidhen nga Personat Kyç të Digjitalizimit.

Së fundmi, u zhvilluan 2 intervista me drejtues të shkollave partnere, të cilët përveçse janë njohës shumë të mirë të platformës MesoVET dhe kanë një vizion të qartë sesi mund të digjitalizojnë disa prej proceseve në shkollë. Këto intervista theksuan nevojën për një person kyç i cili është i angazhuar me kohë të plotë për të menaxhuar iniciativë të ndryshme lidhur me teknologjinë brenda shkollës.

Roli i Personit Kyc të Digjitalizimit në transformimin digjital në arsimin dhe formimin profesional

Qëllimi i rolit të Personit Kyç të Digjitalizimit

Objektivi kryesor i këtij roli është të sigurojë që teknologjia të integrohet plotësisht në çdo aspekt të funksionimit të shkollës, duke lehtësuar jo vetëm procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, por edhe administrimin e brendshëm. Kjo nënkupton ofrimin e asistencës teknike dhe pedagogjike për mësuesit dhe nxënësit, duke i mbështetur ata në adoptimin e teknologjive të reja që e bëjnë të nxënët më interaktiv dhe të aksesueshëm.

Përmes punës së tij/saj, Personi Kyç i Digjitalizimit kontribuon në rritjen e aftësive teknologjike të stafit dhe nxënësve, duke bërë që përdorimi i teknologjisë të kthehet në një pjesë integrale të përmirësimit të rezultateve të tyre. Në afatgjatë, roli i tij synon të kontribuojë në krijimin e një kulture digjitale brenda shkollës, ku teknologjia nuk përdoret thjesht për të lehtësuar detyrat administrative apo mësimore, por për të transformuar mënyrën se si zhvillohet dhe ofrohet arsimi.

Konteksti i zhvillimit të rolit të Personit Kyc të Digjitalizimit

Përditësimi dhe riorganizimi i platformës MesoVET pati një ndikim të rëndësishëm në mënyrën sesi do të menaxhohej ajo brenda shkollave. Gjatë partneritetit për modernizimin e IoAFP-ve , u vu re që përveç specialistëve të jashtëm të platformave të vënë në dispozicion nevojat e shkollave dhe stafit ishin specifike dhe shpesh kërkonin një ekspertizë të brendshme të ofruar drejtpërdrejtë në shkollë. Që nga tetori i vitit 2022, platforma MesoVET nuk funksiononte më thjesht si një mjedis i përbashkët për të gjitha shkollat, por u transformua në Moodle Workplace, e cila i mundësonte secilës shkollë të kishte një hapësirë të quajtur *tenant*, duke e bërë platformën më të personalizuar për secilën shkollë.

Ky ndryshim solli nevojën për një administrator të brendshëm në shkollë, i cili fillimisht do të punonte ngushtësisht me ekspertët e digjitalizimit të projektit, të cilët u quajtën ‘Digital Focal Point’ (DFP). Duke qenë se funksionalitetet e platformës mbetën të njëjta, për këtë rol u përzgjedhën mësues që kishin një njohuri të mirë të platformës, duke bërë që roli i ri të integrohej natyrshëm në shkollë. Që prej fillimit, Personat Kyç të Digjitalizimit u pajisën me një set të qartë detyrash dhe përgjegjësish. Për të përmbushur këto detyra në mënyrë sa më efektive, ata u trajnuan përmes një serie trajnimesh që synonin jo vetëm përdorimin teknik të platformës, por edhe krijimin e një vizioni të qartë sesi platformat digjitale mund të jenë promotorë të inovacionit në shkollë.

Viti i parë i implementimit nxori në pah rëndësinë e të pasurit një ekspert teknik brenda shkollës, i cili do të lehtësonte procese si aplikimi i mësimit të kombinuar, provimet e nivelit përmes Mësovet, si dhe kapacitimi i mësuesve të rinj lidhur me përdorimin e teknologjive arsimore. Pas dy viteve, u vërejt se ky rol ishte tashmë i konsoliduar dhe ishte e nevojshme që të bëhej pjesë e organikës së shkollës. Jo vetëm kaq, por kjo nevojë kërkonte ridimensionimin e pozicionit dhe detyrave të tij, në mënyrë që të ishte më i afërt me iniciativat dhe planin e shkollës për digjitalizimin.

Nga përvojat e mbledhura gjatë këtij procesi, do të paraqitet një profil i detajuar i Personit Kyç të Digjitalizimit, i cili do të jetë i përshtatshëm për t'u replikuar edhe në shkollë të tjera që nuk janë partnere të projektit ‘Aftësi për Punë’.

Profili i Personit Kyç të Digjitalizimit

Personi Kyç i Digjitalizimit duhet të jetë i pajisur me një gamë të gjerë aftësish që përfshijnë teknologjinë, pedagogjinë dhe komunikimin. Deri më tani, ky rol është mbajtur nga një mësues i shkollës, i cili është përqendruar kryesisht në mbështetjen teknike të mësuesve dhe nxënësve për përdorimin e platformës MësoVET. Megjithatë, në plan afatgjatë, roli i Personit Kyç të Digjitalizimit nuk duhet të kufizohet vetëm në ofrimin e mbështetjes teknike për një platformë specifike si MësoVET. Ky rol duhet të evoluojë për të përmbushur kërkesat gjithnjë e më komplekse të digjitalizimit në AFP.

Aktualisht, në shkollat profesionale, roli i Personit Kyç të Digjitalizimit është mbajtur nga mësues me profile të ndryshme, duke përfshirë mësues që shërbejnë si Nëndrejtorë, Kryetarë të Njesisë së Zhvillimit, mësues të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), Koordinator i Kurrikulës, si dhe mësues të tjerë me aftësi të mira digjitale. Kjo larmishmëri në aspektin profesional ka sjellë përfitime të konsiderueshme për shkollat përkatëse, pasi çdo mësues ka sjellë në këtë rol një kombinim unik të aftësive të tyre.

Duke u bazuar në këtë përvojë, është e rëndësishme që përpara se të zgjidhet Personi Kyç i Digjitalizimit, të kryhet një vlerësim i kujdesshëm për të kuptuar se cilat janë nevojat specifike të shkollës dhe cili person do të ishte më i përshtatshëm për këtë pozicion. Duke qenë se ky rol është relativisht i ri dhe kërkon jo vetëm njohuri në menaxhimin e teknologjisë, por edhe punë intensive për të bindur mësuesit dhe stafin për përdorimin e teknologjisë në mënyrë efektive në shkollë, mësuesi që zgjidhet për këtë pozicion duhet të ketë një kombinim të mirë aftësish.

Pozicioni që ai ose ajo mban aktualisht në shkollë është një avantazh i madh, pasi përvoja profesionale e mësuesit ndikon pozitivisht në ndërveprimin dhe ndikimin që ka te stafi dhe mësuesit, duke i inkurajuar ata të jenë më të hapur ndaj ndryshimeve digjitale. Përveç aftësive teknike, mësuesi që shërben si Person Kyç i Digjitalizimit duhet të zotërojë aftësi të shkëlqyera komunikuese për të transmetuar në mënyrë të qartë dhe efektive informacionin, për të motivuar stafin dhe për të krijuar një kulturë të qëndrueshme digjitale brenda shkollës.

Më poshtë janë shtjelluar aftësitë kryesore që duhet të zotërojë Personi Kyç i Digjitalizimit. Këto aftësi ndihmojnë për të kuptuar më mirë fushat ku duhet të përqendrohet zhvillimi i vazhdueshëm i tyre, me qëllim rritjen e kapaciteteve për të përmbushur më mirë përgjegjësitë e këtij roli dhe për t'i shërbyer në mënyrë më efikase shkollës.

Aftësitë Teknike

Së pari, Personi Kyç i Digjitalizimit duhet të jetë një mësues i shkollës, një individ që e njeh mirë mjedisin arsimor dhe proceset e përditshme që ndodhin brenda saj. Kjo është thelbësore për ta bërë rolin e tij të vlefshëm dhe të përshtatshëm për nevojat e institucionit. Njohuritë teknike që duhet të zotërojë përfshijnë:

- **Njohuri të mira të mjeteve digjitale** si platforma mësimore, aplikacionet edukative, dhe softuerët administrativë. Platforma si MësoVET dhe mjete të tjera të ngjashme janë elemente thelbësore për të siguruar një mjedis digjital funksional dhe të qëndrueshëm për nxënësit dhe mësuesit.
- **Njohuri në menaxhimin të të dhënave**, duke përfshirë krijimin dhe mirëmbajtjen e llogarive të përdoruesve, përditësimin e kurseve, administrimin e dokumenteve digjitale dhe sigurinë e të dhënave.
- **Aftësi të mira në zgjidhjen e problemeve teknike**, që do të thotë të jenë të aftë të adresojnë dhe të zgjidhin problemet që mund të lindin gjatë përdorimit të teknologjisë.

Për shembull, në rast të ndërprerjes së shërbimit ose ndonjë problemi të platformës, duhet të kenë aftësinë të veprojnë me shpejtësi dhe efikasitet për të shmangur ndonjë ndikim në procesin mësimor.

- **Aftësi të mira për të identifikuar nevojat specifike të shkollës** dhe për t'i përkthyer ato në zgjidhje teknike të përshtatshme. Kjo nënkupton aftësinë për të analizuar sfidat dhe kërkesat e ndryshme që lindin në shkollë, qoftë në aspektin pedagogjik apo administrativ, dhe për të propozuar teknologjitë ose platformat më të përshtatshme që do të ndihmojnë në adresimin e këtyre nevojave. Këto aftësi janë thelbësore për të siguruar që teknologjia e përdorur të jetë në përputhje me objektivat dhe kërkesat e shkollës, duke optimizuar në këtë mënyrë efektivitetin e saj në mësimdhënie dhe menaxhim.

Aftësi koordinuese

Implementimi i iniciativave teknologjike dhe digjitalizimit në arsim kërkon aftësi praktike koordinimi. Personi Kyç i Digjitalizimit duhet të jetë në gjendje të organizojë dhe menaxhojë në mënyrë efektive proceset e implementimit të teknologjisë, duke u siguruar që të gjithë anëtarët e stafit dhe nxënësit të punojnë në harmoni drejt një qëllimi të përbashkët. Aftësia për të koordinuar jo vetëm përdorimin e pajisjeve teknologjike, por edhe aktivitetet e përditshme që lidhen me teknologjinë, është thelbësore për të siguruar që të gjithë kanë informacionin dhe udhëzimet e duhura. Mësuesi që mban këtë rol duhet të jetë i aftë të koordinojë trajnime, të ofrojë mbështetje teknike, dhe të kryejë monitorim të vazhdueshëm për të siguruar që të gjithë pjesëmarrësit janë të vetëdijshëm dhe të aftë për të përdorur në mënyrë efektive teknologjitë e reja.

- **Aftësi planifikimi dhe menaxhimi:** Personi Kyç i Digjitalizimit duhet të zotërojë aftësi të mira në planifikimin e aktiviteteve që mbështesin procesin e digjitalizimit, duke filluar nga trajnimi i mësuesve deri te zbatimi i projekteve të përbashkëta me nxënësit dhe stafin. Këto aktivitete përfshijnë gjithashtu hartimin e strategjive afatgjata për integrimin e teknologjisë në procesin mësimor dhe menaxhimin e burimeve teknologjike të shkollës. Duke qenë se ai/ajo është përgjegjës për përparimin e këtyre iniciativave, aftësitë menaxheriale janë të rëndësishme. Personi Kyç duhet të sigurojë që secili pjesëmarrës ka një rol të qartë dhe po përmbush detyrimet e tij në mënyrë efektive.
- **Aftësi të mira për të deleguar detyra në procese të caktuara,** duke përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e secilit anëtar të stafit në varësi të aftësive dhe përvojave të tyre. Kjo ndihmon në sigurimin e një ndarjeje efektive të punës, duke u mundësuar çdo individ që të përqendrohet në fushat ku ka më shumë kompetencë, gjë që rrit efikasitetin e përgjithshëm të ekipit dhe përshpejton arritjen e objektivave të digjitalizimit. Për më tepër, një delegim i mirë strukturon më mirë proceset dhe nxit një ndjenjë përgjegjësie dhe angazhimi në ekip.

Aftësi pedagogjike

Një nga përgjegjësitë kryesore të Personit Kyç të Digjitalizimit është të ndihmojë mësuesit në përdorimin e teknologjisë për të përmirësuar procesin e mësimdhënies. Prandaj, ky pozicion duhet të mbahet nga një mësues që njih shumë mirë metodat e mësimdhënies. Ai/ajo duhet të sugjerojë përdorimin e teknologjisë dhe mjeteve digjitale në përputhje me nevojat e lëndës dhe objektivat e saj, me qëllim lehtësimin e procesit mësimor.

Përdorimi i aktiviteteve digjitale duhet të jetë i tillë që të bëjë mësimin më interaktiv dhe të nxisë diskutimin e pjesëmarrjen e nxënësve në procesin e të nxënësve. Nëse Personi Kyç i Digjitalizimit nuk i njih këto metodologji, do të jetë e vështirë për të krijuar një lidhje efektive midis teknologjisë dhe mësimdhënies.

- **Mbështetje në planifikimin e orës mësimore:** Personi Kyç i Digjitalizimit duhet të ndihmojë mësuesit në planifikimin e orëve mësimore duke përfshirë **aktivitete dhe veprimtari digjitale** që nxisin diskutim, ndërveprim dhe zhvillimin e aftësive të nxënësve. Ai/ajo duhet të jetë në gjendje të sugjerojë strategji që e bëjnë procesin mësimor më dinamik dhe të angazhojë më shumë nxënësve, duke përdorur teknologjinë për të krijuar mësim interaktiv dhe për të lehtësuar mësimnxënien e përbashkët.
- **Aftësi për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e materialeve digjitale:** Personi Kyç duhet të zotërojë aftësi për të zhvilluar materiale digjitale që përputhen me objektivat e lëndës dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të përdorshme në klasë. Ai/ajo duhet të ketë një kuptim të mirë të materialeve mësimore digjitale, të jetë në gjendje t'i krijojë, përditësojë dhe t'i përshtatë këto materiale sipas nevojave të orës mësimore. Gjithashtu, ai/ajo duhet të jetë i aftë të vërë këto materiale në funksion për të mbështetur mësimin në mënyrë që të përmirësojë rezultatet e nxënësve dhe t'i ndihmojë ata të angazhohen më mirë në procesin e të nxënësve.

Aftësi komunikimi

Një aspekt shumë i rëndësishëm i profilit të Personit Kyç të Digjitalizimit është aftësia për të komunikuar në mënyrë efektive me të gjithë aktorët e përfshirë në procesin arsimor – nga mësuesit dhe nxënësit deri te administrata. Komunikimi me mësuesit dhe stafin është thelbësor për t'i mbështetur ata në përdorimin e teknologjisë në përditshmërinë e tyre dhe për t'u siguruar që ata të ndihen të aftë dhe të përgatitur për ta përvetësuar atë në procesin mësimor. Personat Kyç të Digjitalizimit duhet të jenë në gjendje të organizojnë sesione trajnimit dhe takime informuese, duke përçarur qartë përfitimet e digjitalizimit dhe duke ndihmuar në përfshirjen e teknologjisë në strategjitë mësimore.

- **Vizioni i qartë i përfitimeve të digjitalizimit dhe përçimi i informacionit:** Personi Kyç duhet të ketë një vizion të qartë mbi përfitimet që teknologjia sjell në edukim dhe të jetë në gjendje t'i komunikojë këto përfitime në mënyrë të kuptueshme për të gjithë aktorët e përfshirë. Ky proces mund të realizohet përmes takimeve informuese, trajnimeve të mirëstrukturuara dhe mbështetjes së vazhdueshme, duke ndihmuar mësuesit dhe nxënësit të përvetësojnë teknologjinë si pjesë integrale të procesit mësimor. Përçimi i informacionit në mënyrë të qartë dhe të organizuar krijon një mjedis ku të gjithë kuptojnë rëndësinë e digjitalizimit dhe përfitimet që ai sjell.
- Një tjetër aftësi e rëndësishme e tyre është **aftësia për të inkurajuar të gjithë mësuesit të përfshihen aktivisht në procesin e digjitalizimit**, veçanërisht në rastet kur disa mund ta shohin teknologjinë si një barrë të shtuar apo një sfidë. Personat Kyç të Digjitalizimit duhet të jetë në gjendje të adresojnë këto shqetësime duke shpjeguar qartë përfitimet praktike që teknologjia ofron dhe duke ofruar mbështetje të vazhdueshme për t'i ndihmuar ata gjatë tranzicionit. Krijimi i një ambienti besimi dhe angazhimi është thelbësor për motivimin e mësuesve dhe për t'i ndihmuar ata të përqafojnë ndryshimet digjitale, gjë që është jetike për suksesin e procesit të digjitalizimit në shkollë.

Aftësi Analitike dhe Vlerësimi

Një nga përgjegjësitë kryesore të Personit Kyç të Digjitalizimit është monitorimi i vazhdueshëm i procesit të digjitalizimit në shkollë, duke siguruar që teknologjia të përdoret në mënyrë efektive dhe që të arrihen objektivat e përcaktuara. Personi Kyç duhet të ketë aftësi të mira monitorimi për të ndjekur progresin e përdorimit të teknologjisë nga mësuesit dhe nxënësit, për të identifikuar sfidat dhe për të ofruar mbështetje të vazhdueshme.

- **Aftësia për të vlerësuar efektivitetin e teknologjisë në mësimdhënie:** Personi Kyç duhet të jetë në gjendje të monitorojë se si teknologjia po përdoret në klasë dhe të vlerësojë nëse ajo po ndihmon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve. Kjo përfshin mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e feedback-ut nga mësuesit dhe nxënësit për të identifikuar fushat ku mund të bëhen përmirësime.
- **Aftësia për të analizuar nevojat aktuale dhe potencialin për modernizim të shkollës:** Përveç monitorimit të përdorimit të teknologjisë ekzistuese, Personi Kyç i Digjitalizimit duhet të ketë aftësi të mira për të analizuar dhe kuptuar nevojat aktuale të shkollës për teknologji të reja dhe për modernizim të vazhdueshëm. Kjo kërkon vlerësimin e sistemeve dhe pajisjeve ekzistuese për të identifikuar se si mund të optimizohet procesi i mësimdhënies dhe administrimit. Personi Kyç duhet të jetë në gjendje të parashikojë sfidat teknologjike që mund të dalin në të ardhmen dhe të sugjerojë zgjidhje që përmirësojnë efikasitetin e shkollës, si dhe të nxisin inovacionin.
- **Aftësia për të përkthyer të dhënat në veprime konkrete:** Duke analizuar të dhënat e përdorimit të teknologjisë, Personi Kyç i Digjitalizimit duhet të jetë në gjendje të nxjerrë përfundime të qarta mbi performancën e sistemeve aktuale dhe të propozojë përmirësime.

Kjo aftësi përfshin krijimin e rekomandimeve të bazuara në të dhëna për blerjen e pajisjeve të reja, përmirësimin e platformave ekzistuese, apo integrimin e teknologjive të reja që ndihmojnë në mësimdhënien më interaktive dhe administrimin më efikas.

- **Aftësia për të përcaktuar prioritetet në planifikimin strategjik të digjitalizimit:** Personi Kyç i Digjitalizimit duhet të jetë në gjendje të raportoje dhe të marrë pjesë aktive në planifikimin strategjik të digjitalizimit në shkollë. Kjo lidhet me identifikimin e fushave ku digjitalizimi mund të ndihmojë në përmbushjen e objektivave të shkollës. Personi Kyç duhet të punojë ngushtësisht me stafin drejtues për të përcaktuar prioritetet dhe për të krijuar një plan të qartë veprimi për implementimin e ndryshimeve teknologjike. Detyrat dhe përgjegjësitë

Detyrat dhe përgjegjësitë e Personit Kyç të Digjitalizimit

Personi Kyç i Digjitalizimit luan një rol të rëndësishëm, duke përfshirë jo vetëm detyra teknike, por edhe promovimin dhe integrimin e digjitalizimit në të gjitha aspektet e shkollës. Personat Kyç të Digjitalizimit, të cilët zakonisht janë mësues, përveç zotërimit të aftësive teknike, duhet të kenë kapacitetin për të mbështetur implementimin e teknologjisë në proceset e mësimdhënies dhe të nxënësve. Veprimtaria e tyre shtrihet në disa fusha kyçe, duke përfshirë mbështetjen e përdoruesve të platformave dhe mjeteve digjitale, plotësimin dhe përditësimin e fondit të materialeve mësimore të disponueshme, si dhe analizimin e të dhënave të gjeneruara për të përmirësuar më tej proceset mësimore dhe administrative. Ky rol përfshin gjithashtu ndihmën e mësuesve dhe nxënësve për t'u përshtatur me teknologjinë, duke ofruar mbështetje dhe udhëzime të vazhdueshme.

Duke marrë parasysh larmishmërinë e detyrave ata duhet të realizojnë, më poshtë janë detajuar detyrat e rishikuara, duke reflektuar kontributin e rëndësishëm të drejtuesve, nxënësve dhe Personit Kyç të Digjitalizimit aktualë në shkollë. Ky kontribut vjen duke mbajtur në vëmendje nevojat e shkollës dhe planin afatgjatë për digjitalizimin.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. **Menaxhimi i autentifikimit të përdoruesve në platformë:** Një nga përgjegjësitë kryesore të Personit Kyç të Digjitalizimit është menaxhimi i procesit të autentifikimit për të gjithë përdoruesit e platformës. Përveç krijimit të llogarive, ai është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe përditësimin e llogarive ekzistuese, duke përfshirë përditësimin e fjalëkalimeve, korrigjimin e të dhënave të përdoruesve dhe ndihmën për çdo problem të hasur gjatë hyrjes në sistem. Një aspekt shumë i rëndësishëm i kësaj detyre është regjistrimi i përdoruesve në kurset e tyre përkatëse, duke siguruar që çdo nxënës dhe mësues të ketë akses në materialet dhe aktivitetet e duhura. Në këtë kontekst, siguria dhe mbrojtja e të dhënave janë prioritare. Personi Kyç i Digjitalizimit duhet të sigurohet që procesi i autentifikimit të jetë i mbrojtur për të shmangur aksesin e paautorizuar dhe për të mbrojtur të dhënat personale të përdoruesve.
2. **Zgjidhja e çështjeve teknike për nxënësit dhe mësuesit:** Një nga detyrat kryesore të mbështetjes teknike është zgjidhja e problemeve që nxënësit mund të hasin gjatë përdorimit

të platformës digjitale. Personi Kyç i Digjitalizimit luan një rol të rëndësishëm për të adresuar çdo çështje teknike, qoftë për qasjen në platformë, përdorimin e funksionaliteteve, apo për zgjidhjen e problemeve që lidhen me kryerjen e detyrave dhe veprimtarive. Ndryshe nga nxënësit, mësuesit kanë një sërë të drejtash në platformë, të tilla si menaxhimin e kursit, vlerësimin e nxënësve, përditësimin e materialeve mësimore dhe shtimin e aktiviteteve të reja. Për këtë arsye, mësuesit duhet të jenë të përgatitur për të përdorur platformën në mënyrë optimale, duke garantuar që çdo veprim që ata ndërmarrin të jetë në shërbim të përmirësimit të përvojës së nxënësve. Kjo qasje krijon një hierarki të qartë të zgjidhjes së çështjeve teknike ku nxënësit kërkon asistencë teknike tek mësuesi dhe në rastet kur problemi nuk mund të zgjidhet, ai dërgohet te Personi Kyç i Digjitalizimit për asistencë më të specializuar. Kjo strukturë jo vetëm që ndihmon në qartësimin e roleve dhe përgjegjësi, por gjithashtu siguron që problemet teknike të trajtohen shpejt dhe në mënyrë efektive, duke minimizuar ndërprerjet në procesin mësimor.

3. **Kapacitimi i stafit mësimor:** Mësuesi luan rol vendimtar si hallka e parë në prezantimin e nxënësve me platformat digjitale, të cilat përdoren për të mbështetur procesin mësimor. Për të përmbushur këtë rol me sukses, mësuesi duhet të zotërojë jo vetëm aftësi të mira teknike, por duhet të përcjellë qartë detyrat dhe udhëzimet te nxënësit. Për të mbështetur këtë proces, ai duhet të hartojë një plan gjithëpërfshirës trajnimi, i cili jo vetëm që mbulon aspektet teknike të përdorimit të platformës, por edhe integrimin e saj në planifikimin e orës mësimore. Ky plan duhet të fokusohet në ndërtimin e aftësive për menaxhimin e mësimdhënies me bazë teknologjinë të cilat kombinojnë metodat tradicionale me ato digjitale. Ky proces kapacitimi nuk duhet të kufizohet vetëm në trajnime të izoluar. Përkundrazi, ai duhet të jetë një proces i vazhdueshëm, i cili përfshin një seri seancash mentorimi (coaching) përgjatë gjithë vitit shkollor. Këto seanca duhet të bazohen në identifikimin e nevojave individuale të secilit mësues, duke ofruar mbështetje të personalizuar në përdorimin e teknologjisë për mësimdhënie.
4. **Administrimi dhe dokumentimi i proceseve të brendshme:** Shkollat profesionale përfshijnë një sërë veprimtarish të rëndësishme, si provimet e nivelit, provimet nga drejtoria, si dhe administrimin e dokumentacionit shkollor dhe proceset e lidhura me të. Ky rol përfshin koordinimin e aspekteve teknike duke ndihmuar në përgatitjen dhe administrimin e provimeve online, mbledhjen e të dhënave të nxënësve, dhe përpunimin e rezultateve. Gjithashtu, Personi Kyç i Digjitalizimit krijon një hapësirë të dedikuar në platformë për dokumentimin e proceseve (shembull Arkiva Digjitale). Në këtë kontekst, ata mbështesin stafin mësimor dhe personat në funksione kyçe dhe vihen në rolin e promotorit të iniciativave të digjitalizimit në shkollë.
5. **Përditësimi i strukturës organizative të shkollës:** Personi Kyç i Digjitalizimit është përgjegjës për të siguruar që struktura organizative e shkollës të jetë në përputhje me ndryshimet e vitit shkollor përkatës. Kjo përfshin përditësimin e platformës dhe të dhënave që lidhen me organizimin e klasave, mësuesve dhe nxënësve.

6. **Realizimi i raporteve periodike mbi përdoruesit:** Një nga detyrat kryesore të Personit Kyç të Digjitalizimit është krijimi i raporteve të rregullta mujore dhe vjetore mbi përdorimin e platformës nga mësuesit dhe nxënësit. Këto raporte përfshijnë të dhëna si shkalla e angazhimit të përdoruesve, kohëzgjatja, llojet e aktiviteteve të realizuara dhe progresi i aktiviteteve në kurse. Raportet i komunikohen stafit menaxherial të shkollës, duke ofruar një pasqyrë të qartë të përdorimit të platformës. Përtej thjesht përpilimit të këtyre raporteve, ai luan një rol të rëndësishëm në analizimin e të dhënave të mbledhura. Kjo analizë ndihmon për të identifikuar zonat ku ka vështirësi ose mungesë aktiviteti, për të përcaktuar fushat që kërkojnë përmirësim, si dhe për të nxjerrë në pah praktikatat më të mira që mund të ndahen me mësuesit dhe nxënësit. Për më tepër, në varësi të të dhënave të gjeneruara nga platforma, Personi Kyç i Digjitalizimit mund të sugjerojë iniciativa të reja për të rritur angazhimin e përdoruesve, si përmirësime teknologjike, trajnime të personalizuara për mësuesit ose ndryshime në mënyrën e organizimit të kurseve.
7. **Të shërbejë si mentor transferimi dhe promovojë praktikatat e mira përtej shkollës:** Platforma si Mesovet janë të pasura me një fond të gjerë videosh udhëzuese dhe materiale mbështetëse, që ndihmojnë përdoruesit të orientohen dhe ta përvetësojnë më mirë atë. Megjithatë, duke qenë se platforma ka përditësime të vazhdueshme, Personi Kyç i Digjitalizimit duhet të jetë gjithmonë në gatishmëri për t'i përcjellë këto ndryshime dhe përmirësime përdoruesve në mënyrë efektive. Kjo kërkon që ata të krijojnë dhe të shpërndajnë guida të shkurtra dhe të personalizuara, që u drejtohen si mësuesve, ashtu edhe nxënësve. Këto udhëzime praktike mund të përfshijnë video të reja, tutoriale hap-pas-hapi ose materiale me shkrim. Ky proces i vazhdueshëm trajnimi dhe përcjellje e informacionit ndihmon në krijimin e një autonomie të plotë për mësuesit dhe nxënësit, duke i lejuar ata të ndjekin ndryshimet teknologjike dhe të zhvillojnë aftësi të përhershme për përdorimin e platformës. Nëpërmjet këtij roli, Personi Kyç i Digjitalizimit siguron që të gjitha përditësimet teknologjike të shfrytëzohen në mënyrë optimale, duke rritur në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e procesit mësimor dhe përvojën e përdoruesve në platformë. Është e nevojshme që praktikatat e mira të digjitalizimit të përhapen përtej mjedisit të shkollës profesionale ku operon Personi Kyç i Digjitalizimit. Forume si seminare, vizita studimore dhe komunitete të praktikave janë forma të rëndësishme për përhapjen dijes kolektive dhe mësuar nga njërit-tjetri në AFP.
8. **Të shërbejë si anëtar i grupit të Planifikim Monitorimit të Shkollës:** Personi Kyç duhet të marrë pjesë aktive në këtë strukturë të rëndësishme të institucionit duke analizuar arritjet e objektivave vjetore, duke identifikuar nevojat për zhvillimin e digjitalizimit në shkollë dhe sfidave për të ardhmen dhe duke siguruar që strategjitë afatmesme të shkollës të përputhen me vizionin dhe misionin e një institucioni bashkëkohor.

Zhvillimi profesional i personit kyç të digjitalizimit si agjent ndryshimi në shkollë

Që prej krijimit të rolit të Personit Kyç të Digjitalizimit në vitin 2022, projekti ‘Aftësi për Punë’ ka luajtur një rol kyç në mbështetjen e këtij pozicioni në shkollat profesionale. Ky projekt ka ofruar një sërë trajnimesh të përqendruara në zhvillimin e aftësive të nevojshme për t’i përgatitur këta individë të shërbejnë si agjentë kryesorë të digjitalizimit brenda shkollave të tyre. Trajnimet nuk janë fokusuar vetëm në aspektin teknik, por edhe në promovimin dhe integrimin e platformave digjitale në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Nga përvoja e deritanishme është bërë e qartë se identifikimi i nevojave dhe sfidave me të cilat përballen Personat Kyç të Digjitalizimit është thelbësore për të krijuar një plan efektiv të kapacitimit të tyre. Trajnimet e dhëna deri më tani kanë ndihmuar në përmirësimin e aftësive, por në shumë raste është evidentuar se nevojat janë specifike dhe të ndryshme nga një shkollë te tjetra. Kjo do të thotë se duhet një qasje më e strukturuar për të përmbushur nevojat individuale të secilit Person Kyç.

Një nga sfidat më të mëdha për Personat Kyç të Digjitalizimit është mungesa e aftësive dhe njohurive teknologjike për të mbështetur në mënyrë efektive institucionet e tyre. Edhe pse kanë marrë trajnime, është e domosdoshme që ata të qëndrojnë gjithmonë të përditësuar me zhvillimet e reja. Ndryshimet e shpejta teknologjike dhe platformave arsimore kërkojnë nga ky person jo vetëm të mbajnë nivelin aktual të njohurive, por të adoptojnë dhe implementojnë risi që lehtësojnë procesin mësimor dhe administrativ. Për këtë arsye, është e nevojshme që të ofrohen trajnime të rregullta dhe mundësi për zhvillim profesional të vazhdueshëm.

Gjithashtu, Personat Kyç të Digjitalizimit shpesh përballen me një ngarkesë të madhe pune, pasi ata janë përgjegjës për menaxhimin e të gjitha aspekteve të mjeteve digjitale, përfshirë administrimin dhe mbështetjen teknike. Mësuesit, duke e parë këtë rol si mbështetjen kryesore, shpesh drejtohen tek ata për zgjidhjen e problemeve teknologjike.

Kjo ngarkesë u vendos personave kyç një barrë të madhe përgjegjësish, duke i lënë shpesh me pak kohë për të mbështetur në mënyrë efektive të gjithë stafin dhe nxënësit. Ndryshimi i qëndrimeve të mësuesve ndaj përdorimit të teknologjisë është kyç për lehtësimin e kësaj sfide. Zbatimi i programeve të brendshme trajnuese dhe ndërgjegjësuese dhe zhvillimi i një kulture të përbashkët digjitale brenda shkollës mund të kontribuojë në përmirësimin e situatës.

Zhvillimi profesional i Personave Kyç të Digjitalizimit duhet të fokusohet në tematika dhe nivele të ndryshme. Përpara se ata të marrin këtë rol, është e rekomandueshme që të kryhet një vlerësim i nevojave të tyre për të identifikuar fushat ku kanë nevojë për përmirësim dhe për të përcaktuar se cilat trajnime do t’i ndihmojnë më shumë. Ky proces siguron që zhvillimi profesional të jetë më i përshtatur dhe më efektiv për secilin individ. Më poshtë janë listuar trajnimet e sugjeruara, të cilat do t’i ndihmojnë Personat Kyç të Digjitalizimit të përmirësojnë aftësitë dhe të përmbushin me sukses rolin e tyre.

Trajnimi për përdorimin dhe menaxhimin e platformës Mesovet

Ky trajnim është i nevojshëm për të pajisur **Personat Kyç të Digjitalizimit** me aftësitë e duhura për të administruar dhe mirëmbajtur në mënyrë efektive platformën MesoVET. Gjatë këtijtrajnimi, pjesëmarrësit do të përfitojnë njohuri të thelluara në:

- **Administrimin e platformës:** Personat Kyç të Digjitalizimit do të mësojnë se si të menaxhojnë funksionet kryesore të platformës MesoVET, duke përfshirë menaxhimin e llogarive të përdoruesve, përditësimin e kurseve dhe përmbajtjes mësimore, si dhe kontrollin e aksesit për mësuesit dhe nxënësit.
- **Zgjidhja e problemeve teknike:** Një pjesë kyçe e trajnimit duhet të jetë aftësia për të adresuar dhe zgjidhur shpejt problemet teknike që hasen nga mësuesit dhe nxënësit gjatë përdorimit të platformës. Ata do të përfitojnë aftësi për identifikimin e çështjeve të ndryshme teknologjike dhe për ofrimin e zgjidhjeve të përshtatshme në kohë reale, duke siguruar vazhdimësinë e procesit mësimor.
- **Analizimi i të dhënave të gjeneruara nga platforma:** Një aspekt i rëndësishëm i zhvillimit profesional të Personave Kyç të Digjitalizimit është analiza e të dhënave të gjeneruara nga platforma digjitale. Kjo i ndihmon ata të marrin vendime strategjike për përmirësimin e performancës së platformës, duke propozuar përmirësime që rrisin efektivitetin e përdorimit të teknologjisë në procesin arsimor.

Trajnim për t'u certifikuar si Edukator nga Moodle (Moodle Educator Training)

Programi "Moodle Educator Qualification" (MEQ) është krijuar për mësues dhe profesionistë të angazhuar në fushën e edukimit me përvojë fillestare në përdorimin e Moodle LMS ose Workplace.

Kursi përqendrohet në zhvillimin e aftësive pedagogjike digjitale, duke u bazuar në Kornizën Evropiane për Kompetencat Digjitale të Mësuesve (DigCompEdu). Ai përmban gjashtë kurse që mbulojnë 22 kompetenca dhe në përfundim të tij, pjesëmarrësit pajisen me distinktiva digjital (individual për secilin kurs) dhe një certifikatë zyrtare nga Moodle. Ky program trajnimi ndihmon në përmirësimin e cilësisë së kurseve dhe angazhimin e nxënësve.

Trajnimi për zhvillimin dhe përdorimin e materialeve digjitale

Ky trajnim synon të pajisë **Personat Kyç të Digjitalizimit** me aftësitë e nevojshme për të krijuar, menaxhuar dhe integruar materiale digjitale në platforma si MesoVET, duke u përshtatur me kërkesat e kurikulës dhe nevojat e nxënësve. Ata do të zhvillojnë kompetenca të plota në:

- **Krijimi i materialeve digjitale:** do të mësojnë teknikat për krijimin e materialeve mësimore interaktive dhe të personalizuara në formate të ndryshme digjitale, duke përfshirë video, prezantime, quiz-e interaktive dhe dokumente të strukturuar për të mbështetur mësimin në klasë dhe online.
- **Integrimi i materialeve në platforma:** Gjatë trajnimit, do të mësojnë se si të ngarkojnë dhe të menaxhojnë materialet digjitale në platforma si MesoVET, duke siguruar që ato të jenë të aksesueshme për nxënësit dhe mësuesit.

Programi Pedagogjia Digjitale

Kurse në kuadër të programit ‘Pedagogjia Digjitale’: Këto kurse synojnë të zhvillojnë aftësitë pedagogjike të mësuesve në përdorimin e mjeteve digjitale në mësimdhënie, duke u përqendruar jo vetëm te teknologjia, por edhe te metodologjitë e reja mësimore që mbështesin një përvojë më interaktive dhe efektive të nxënësve. Ky program është i pasur me një seri kursesh të cilat janë të disponueshme në platformën Mësovet dhe mund të ndiqen në mënyrë asinkrone.